

FROM TIRANA TO EUROPE

NGA TIRANA NË EUROPË

Youth Guide on the History & Tradition of the Capital of Youth
Guidë Rinore mbi Historinë & Traditën e Kryeqytetit të Rinisë



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR



BASHKIA
TIRANË



Qendra për
Administrim Social
Ekonomik Territorial

This publication was realized within the Tirana European Youth Capital 2022 program with the financial support of the National Youth Congress in cooperation with the Municipality of Tirana. The content of this publication is the responsibility of the ASET Center and in no way can be considered as the position of the National Youth Congress or the Municipality of Tirana.

“Ky botim është realizuar në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Qendres ASET dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Kongresit Rinor Kombëtar apo Bashkisë Tiranë”.

Përmbajtja/Content

	Faqe/Page		Faqe/Page
Pozicioni gjeografik dhe klima		Tirana pas viteve 1990	
Geographical location and climate	3-4	Tirana after the 1990's	34-41
Prejardhja e emrit Tiranë		Atraksione të Tiranës	
The origin of the name of Tirana	5-7	Attractions of Tirana	42-59
Historiku i Qytetit		Kostume popullore	
The history of the City	8-15	Folk Costumes	60-73
Planet rregulluese të Qytetit		Etnografi	
History of urban Planning.....	16-21	Ethnography	74-93
Tirana gjatë Luftërave Botërore		Kartolina	
Tirana During World Wars.....	22-25	Postcards	94-99
Tirana 1944-1990		Foto Ekspozitë	
Tirana 1944-1990	26-33	Photo Exhibition	100-105

Geographical location and climate



Tirana is situated on an average altitude of 114 m above sea level and extends over the southeastern extremity of Tirana Plain in between Dajti Mountain to the east and Kërraba Hills and Sauk to the south, Vaqarr and Yzberisht hills to the west and Kamza hills to the north. The hills surrounding Tirana reach up a maximum height of 250-300 m.

The climate of Tirana is Mediterranean, with mild, rainy winters and hot, sunny summers. The average annual temperature in Tirana is 15° C, January's average is 6,7° C, July's average temperature is 23,8° C, whereas the absolute maximum temperature is 41,5° C (13.07.1973), and the absolute minimum temperature is -10,4° C (15.01.1968).



Pozicioni gjeografik dhe klima



Tirana ndodhet në një lartësi mesatare 114 metër mbi nivelin e detit dhe shtrihet në skajin juglindor të fushës së Tiranës, ndërmjet malit të Dajtit në Lindje, kodrave të Kërrabës dhe të Saukut në Jug, kodrave të Vaqarrit dhe Yzberishit në Perëndim dhe kodrave të Kamzës në Veri. Kodrat që rrethojnë Tiranën shkojnë deri në 250-300 m lartësi. Tirana bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare fushore që përfshin gjithë Ultësirën Bregdetare dhe që karakterizohet nga dimri relativisht i butë e i lagësht dhe nga vera e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore në Tiranë është 15°C , mesatarja e janarit $6,7^{\circ}\text{C}$, mesatarja e korrikut $23,8^{\circ}\text{C}$, maksimumi absolut $41,5^{\circ}\text{C}$ (13.07.1973), minimumi absolut $-10,4^{\circ}\text{C}$ (15.01.1968).



The origin of the name of Tirana




Based on the Byzantine chronicler of 7-th century, Prokop of Cesarea, some historians consider the name of today's Tirana originating from that of the castle of Tyrkanos. As a toponym, in today's form, Tirana is mentioned for the first time (as a village or as a plain, not sure) in the first quarter of the 14-th century. During 15-th century its name occurs in three forms: Tirana e Vogël (Tyrrana Minor), as a plane, wherein extends today's capital; Tirana e Madhe (Tyrrana Major), as a plain, extending over from

the northwest and finally, Tirana (Tyrranna) unqualified, which form is supposed to have been a residential place in Tyrrana Minor/Tirana e Vogël.

In 1583 Tirana appears in the ottoman books of accounts/tax books (defter), as a village of 8 households of which 7 belonged to the Muslim confession and 1 of Christian confession.

Another variant is the one presented by Teki Selenica in the 1929 publication of "Shqypnija e Ilustrueme"/"Albania



The origin of the of Tirana

Illustrated". According to this publication, the name of Tirana derives from Latin word "tyros" or Greek word "tuross" (cheese), which implies that this area was developed in dairy products. The followers of this hypothesis do connect it to the fact that Illyrians were also good in dairy products and trading especially that of sheep cheese. Probably, the plain of Tirana was called as such due to the sheep cheese being produced and traded there.

The third version relates more to etymology



and is based on the local language word group "të ranat"/"sediments", which implies a field or lowland that is created by the solid materials of waters bodies flowing over. the same line of logic applies to the origin of the name of river Lana, namely, what is left, thus, the solid materials left behind by the flow of the stream/river that still runs across the city.

Anyway, the fact that the origin of the name of Tirana has no exhaustive and convincing explanation, it does not make it a unique case; there are well known European cities which names are not clearly explained either.

Disa historianë shohin tek emri i kalasë Tyrkanos, që e përmend kronisti bizantin i shek. VI, Prokopi i Cezaresë, emrin e Tiranës së sotme. Si emër vendi, në trajtën e sotme Tirana përmendet për të parën herë (si fshat apo si fushë nuk është e sigurt) në çerekun e fundit të shek. XIV. Në shek. XV emri i saj përmendet në tri trajta: Tirana e Vogël (Tyra Minor), si emër fushe ku shtrihet kryeqyteti i sotëm; Tirana e Madhe (Tyra Major), si emër fushe, vazhdim i saj nga ana veriperëndimore dhe në fund Tirana (Tyrranna) e pacilësuar, e cila supozohet të ketë qenë qendër banimi në Tiranën e Vogël. Në vitin 1583 Tirana del e shënuar në defterin osman si një fshat me 8 shtëpi nga të cilat 7 myslimane dhe një e krishterë.

Një tjetër variant është ai i prezantuar nga Teki Selenica në botimin e tij të vitit 1929 "Shqypnija e Ilustrueme". Sipas këtij botimi, emri Tiranë vjen nga fjala latinisht tyros e greqisht turos (djathë), çka nënkupton një zonë me bulmet. Mbështetësit e kësaj hipoteze e lidhin këtë gjë me faktin se ilirët si blegtorë të zotë ishin të njohur për prodhimin dhe tregtinë e djathit të deles. Ndoshta fusha e Tiranës u quajt kështu sepse aty prodhohej dhe shitej djathi i deles.

Versioni i tretë ka të bëjë më tepër me etimologjinë dhe mbështetet në hipotezën e transformimit të togfjalëshit vendas "të ranat", që nënkupton një fushë të formuar nga prurjet e ngurta të ujërave që rridhin në të. Me të njëjtën logjikë mendohet se ka ardhur edhe emri i lumit të Lanës, dmth. "të lana", pra mbetjet e ngurta që linte pas përroi/ lumi që kalon ende në mes të qytetit.

Gjithsesi, fakti që prejardhja e emrit të kryeqytetit nuk ka një shpjegim të plotë e bindës, nuk e bën atë një rast të veçantë. Ka edhe kryeqytete të njohura europiane, emri i të cilëve nuk është shpjeguar ende saktësisht.

Prejardhja e emrit Tiranë



The history of

In 1614, a Sanjak Bey/ (Administrative-military head of a district or administrative unit in Ottoman Empire) named Sulejman Pashë Bargjini, build in today's city centre a mosque, an inn, a hammam/Turkish bath and a bakery which do not exist nowadays. The location of the buildings was not accidental(they were on the crossroads of commercial routes used by caravans.

By 1707 Tirana counted 400 houses and with the passing of time it became one of the key cities of central Albania. While still under



the rule of the scions of the original founders, Tirana was envied by the neighboring landlords. In the fight to conquer Tirana, the Kruja landlords are the ones to remember i.e. scions of the Toptani Family. Ibrahim Pashë Bargjinolli and his heirs ruled these lands, intermittently, until 1818, time when Kapllan pashë Toptani finally came to rule over the city. During 19-th century Tirana

of the city



in 1821 and has the clock tower next to it. Another characteristic compound was that of the Old Bazaar which destroyed during communism so as to build the Palace of Culture.

By mid 19-th century the kaza of Tirana (administrative unit) was no longer an administrative part of the Sanjak of Ohrid (vilayet of Monastery) and was attached to that of Durrës which was part of the vilayet of Shkodër. At this time, Tirana was still a

experienced a certain economic, social and cultural development. The city started its first urbanization steps that were preserved as such until the end of WW1. Buildings began to introduce more windows, small and modest mosques were replaced by new, modern looking ones which had colorful frescoes with floral and arabesque motifs; out of all the mentioned mosques only the mosque of Et'hem Bey has survived, it was build



The history



backward city. It only had one Madrasa (Islamic education institution/school). Average to rich families took their children to more developed cities of the Ottoman Empire as well as in Western Europe.

By 1908, after the Young Turks revolution, the citizens of Tirana who so far were involved into a cultural movement stepped up their demands by establishing the movement for Albania's autonomy. On 1912 they formed patriotic groups in the build up of the general uprising against Ottoman rule. Tirana was represented

by 2 delegates in the National Assembly of Vlora wherein was proclaimed Albania's independence, on November 28, 1912. During the First Balkan War, two days before the proclamation of independence, Tirana was occupied Serbian troops. After the withdrawal of Serbian troops in April 1913 and Prince Wied's short lived reign, Tirana plunged into anarchy as a result of the uprisings led by Esad Pasha and Haxhi Qamili; the anarchy went on until the uprising was crushed by Serbian forces which re-occupied Tirana in June 1915.



of the city

Later on, during WW1, in January 1916, Tirana was occupied by the Austro-Hungarian army and by the end of the war it was occupied by Italian army.

The Albanian state institutions established by the Congress of Lushnjë in 1920 were seated in Tirana (on February 11, 1920) which was temporary assigned as the capital of Albania. From this period on, Tirana started to become populated by people coming in from other regions and cities of the country. In 1922 Tirana became a Prefecture on its own and by 1923 it counted 12.453 inhabitants. In January 1925, Tirana finally became the capital of the Republic of Albania.



Historiku i



një nga qytetet më kryesore të Shqipërisë së Mesme. Ndërkohë, ende nën pushtetin e pasardhësve të themeluesit të saj, Tirana tërhoqi lakminë e feudalëve të viseve fqinje. Në luftën për zotërimin e saj u dalluan feudalët e Krujës - pinjollët e familjes Toptani. Ibrahim Pashë Bargjinolli dhe pasardhësit e tij e mbajtën, me disa ndërprerje, pushtetin mbi trevën deri në vitin 1818, kur Kapllan pashë Toptani e

Në vitin 1614, një sanxhakbej me emrin Sulejman Pashë Bargjini, ndërtoi në qendrën e sotme të kryeqytetit një xhami, një han, një hamam dhe një furrë, të cilat nuk ekzistojnë më sot. Përzgjedhja e këtij vendi nuk ishte pa qëllim, sepse në të kryqëzoheshin disa rrugë të rëndësishme tregtare të karvanëve.

Në vitin 1707 Tirana kishte 400 shtëpi dhe me kalimin e kohës u shndërrua në



një qyteti

shtiu Tiranën përfundimisht në dorë. Gjatë shek. XIX Tirana njohu njëfarë zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor dhe artistik. Qyteti mori trajtën urbanistike që e ruajti deri në fund të Luftës së Parë Botërore. U ngritën ndërtesa me dritare. Vendin e xhamive të thjeshta e zunë xhamitë e reja të zbukuruar me shtylla të pajisura me kapitele dhe me afreske shumëngjyrëshe me motive floreale dhe arabeska; prej tyre ruhet vetëm Xhamia e Haxhi Ethem Beut, e vitit 1821, me kullën e sahatit pranë saj. Pjesë karakteristike ishte



kompleksi i Çarshisë (Pazari i Vjetër), që u prish gjatë ndërtimit të Pallatit të Kulturës. Rreth mesit të shek. XIX kazaja e Tiranës u shkëput administrativisht nga sanxhaku i Ohrit (vilajeti i Manastirit) dhe u lidh me atë të Durrësit, i cili bënte pjesë në vilajetin e Shkodrës. Në këtë kohë Tirana ishte ende qytet i prapambetur. Kishte vetëm një medrese kuranore. Familjet me të ardhura të mira i dërgonin fëmijët për t'u arsimuar në qytete të zhvilluara të Perandorisë Osmane, madje dhe në disa qytete të Perëndimit.

Historiku i



Pas vitit 1908, me fitoren e revolucionit xhonturk, banorët e Tiranës kaluan nga lëvizja kulturore, në lëvizjen për autonominë e Shqipërisë. Më 1912 edhe qytetarët e Tiranës formuan çeta patriotike në kuadrin e kryengritjes së përgjithshme kundërosmane. Tirana u përfaqësua me dy delegatë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, që shpalli Pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Por gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Tirana u pushtua nga ushtritë serbe dy ditë para se të shpallej Pavarësia. Pas

largimit të ushtrive serbe në prill 1913 dhe pas periudhës 6-mujore të qeverisjes së princ Vidit, Tirana u zhyt në anarkinë e krijuar nga kryengritja esadiste dhe ajo e Haxhi Qamilit, derisa kjo u shtyp nga ushtria serbe, të cilat në qershor 1915 ripushtuan Tiranën, për të dytën herë. Më pas, gjatë Luftës së Parë Botërore, në janar 1916, Tirana u pushtua nga ushtria austro-hungareze, kurse në fund të luftës nga ushtria italiane.



një qyteti

Organet e larta të shtetit shqiptar, që dolën më 1920 nga Kongresi i Lushnjës (shih) u vendosën më 11 shkurt 1920 në Tiranë, që u caktua përkohësisht kryeqytet i Shqipërisë, kurse përfundimisht Tirana u shpall si kryeqytet me statutin e Republikës Shqiptare në janar 1925. Pas 1920 filloi popullimi me banorë të ardhur nga krahina e qytete të tjera të vendit. Më 1922 Tirana u shkëput si nënprefekturë nga prefektura e Durrësit dhe u bë prefekturë më vete. Më 1923 ajo kishte 12.453 banorë.



History of urban planning/reg



The stability that characterized the 15 years governance of A. Zogu helped in the development of Tirana. The Albanian governments of the time accelerated the work for the preparation of the urban planning which was a novelty for Tirana. As it happens nowadays even then, there was the dilemma of whether to build a totally new city outside of the old town or should the old town be touched upon as well. The final solution was a compromise in between the two options. The first regulatory plan of Tirana was prepared


in 1923. Some authors opine that it was drafted by Eshref Frashëri, others say that it was prepared by Austrians. Anyhow, this initial plan was never implemented and was followed by another during 1925-1927 which was funded by (SVEA)/ the Italian Association for the Economic Development of Albania and it was prepared by the Italian architect, Armando Brasini. Brasini designed the main boulevard (north-south axis), the



Regulatory plans in Tirana

main square and another square to the north side wherein was provided for the traditional style buildings. Whereas the new buildings would be of classical and neo classical style of the end of 19-th century. This plan couldn't be realized due to high construction costs but the ideas of Brasini are to be used in all subsequent regulatory plans of Tirana.

The third regulatory plan/urban planning of the capital was drafted in 1928 by the Austrian architect Köhler. The specialty of this plan is in that it included the whole city.



Even though it retained the boulevard as proposed by Brasini as well as the two most important buildings of the city i.e. the clock tower and the mosque of Et'hem Bey, the plan was not approved.


A year later, in 1929, a fourth plan was drafted and approved. It was authored by Florestano de Fausto, an Italian architect. Together with the boulevard, this plan also included the compound of the ministries

History of urban planning/ regulatory plans in Tirana



and the municipality buildings. It also provided for the preservation of those buildings that were key to the city's identity such as the clock tower, the mosques and the Old Bazaar. In 1931, the ensemble of the ministries buildings was built on the Scanderbeg Square; in 1938, the central bank of Albania was built and the first radio station did complete enabling the opening of Radio Tirana which did start with limited programs. It was the time, for Tirana e Re/New Tirana to take shape, the newest neighborhood

rwages on both sides of the stream. Citizens did use water wells for their own supply. Old Tirana was made of adobe brick low houses. Here and there one could find sparks of cultural and artistic life. Tirana used to have three high schools, two for boys and one for girls. Three cinemas were built. By this time there started some theatrical shows, artistic programs and sports clubs. During the 1930's the population of the city grew from 31.000 to 38.000 (1938).




Planet rregulluese të qytetit



Stabiliteti i periudhës 14-vjeçare të qeverisjes së A. Zogut ndihmoi për zhvillimin e Tiranës. Qeveritë shqiptare të asokohe përshpejtuan punën për hartimin e një plani rregullues, çka përbënte risi për qytetin. Sikurse ndodh edhe sot, dilema ndërmjet “të vjetrës dhe të resë” ishte e pranishme edhe atëherë dhe shtrohej pyetja nëse duhej të ndërtohej një qytet i ri jashtë qytetit të vjetër apo duhej prekur edhe qyteti i vjetër. Sikurse ndodh gjithmonë, u arrit një kompromis.

Plani i parë rregullues i qytetit u përgatit në vitin 1923. Disa autorë mendojnë se ai u hartua nga Eshref Frashëri, ndërkohë që të tjerë

mendojnë se plani është përgatitur nga austriakët. Gjithsesi ky ishte një plan që nuk gjeti zbatim dhe u pasua disa vite më vonë, në vitet 1925-1927 nga një tjetër plan, i cili financohej nga Shoqëria italiane për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë (SVEA) me një arkitekt italian, Armando Brasini. Brasini parashikonte ndërtimin e bulevardit kryesor në aksin Veri-Jug, sheshin qendror dhe një shesh tjetër në Veri, ku parashikohej të lireshin ndërtimet e traditës. Ndërtimet e reja do të ishin të stilit klasik dhe neoklasik të fundshekullit XIX. Ky plan nuk mund të zbatohet për shkak të kostove të larta të



Planet rregullu



do të miratohej. Autor i tij ishte arkitekti italian Florestano de Fausto. Së bashku me bulevardin kryesor u projektuan edhe kompleksi i ministrive dhe bashkia e qytetit. Po ashtu, plani parashikoi ehe ruajtjen e objekteve të rëndësishme të identitetit kryeqytetas, si kulla e sahatit, xhamitë, Pazarin e Vjetër etj. Në vitin 1931 u ngrit ansambli i ndërtesave të ministrive në sheshin "Skënderbej"; më 1938 përfundoi ndërtimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe u ngrit radiostacioni dhe filloi nga puna Radio Tirana me emisione të kufizuara. Filloi të marrë formë e të rritet gjithnjë e më shumë Tirana e

ndërtimeve por idetë e Brasinis do të gjenin vend në të gjithë planet e mëvonshme rregulluese të qytetit.

Plani i tretë rregullues i kryeqytetit u hartua në vitin 1928 nga arkitekti austriak Köhler në vitin 1928. E veçanta e tij ishte se në të përfshihej gjithë qyteti. Ndonëse ai ruajti bulevardin e propozuar nga Brasini dhe përfshiu në të dy nga ndërtesat më të rëndësishme të identitetit të qytetit Kullën e Sahatit dhe Xhaminë e Et'hem Beut, ai nuk u miratua.

Një vit më vonë, në vitin 1929 u hartuan plani i katër rregullues i Tiranës, i cili edhe



ese të qytetit

Re, pjesa e re e qytetit me vilat e funksionarëve e me rrugë të drejta, ndërsa Tirana e Vjetër ishte pjesa ku zhvillohej jeta ekonomike dhe banonte shumica dërrmuese e qytetarëve, me shtëpi të ulëta, me rrugë e rrugica të ngushta. Ato ndaheshin në mes nga përroi i Lanës. Në të dy pjesët nuk kishte ujësjellës dhe as kanalizime për ujërat e zeza. Qytetarët furnizoheshin me ujë nga puset. Në Tiranën e vjetër mbizotëronin shtëpitë me qerpiç. Filloi gjallërimi i jetës kulturore e artistike. Tirana kishte tri shkolla të mesme (dy për djem e një për vajza). U ndërtuan tri kinema. Filluan shfaqjet teatrale, programet artistike dhe organizimi i klubeve sportive. Gjatë viteve 1930 popullsia e kryeqytetit u rrit nga 31 mijë banorë në vitin 1930 në 38 mijë banorë në vitin 1938.



Tirana du



Albania was occupied by Italy on April 7, 1939, Tirana citizens were all protesting against the occupation. Italian forces entered Tirana on April 8. Italian occupation lasted until September 8, 1943 when the German troops entered in. During the war the civic resistance was growing. Within the city, this resistance started through political action and anti fascist demonstrations then followed with armed operations (guerrilla units) to culminate with establishment of

anti fascist institutions (national liberation councils). The German military invasion did not lessen the intensity of the Anti-fascist National Liberation War in Tirana. Four brigades (II, III and XXII). Tirana was liberated on November 17, 1944. On November 28, 1944, on the 32-nd Anniversary of Independence, in Tirana was established the democratic government that was based the second meeting of the Anti-fascist National Liberation Council that was held in Berat. During 1939-1944 many public buildings



uring WW2 ...



were constructed in Tirana from the private investment of both Italians and locals that aimed at improving the economic and urban infrastructure of the capital. Amongst those buildings could mentioned hotel Dajti, the Prime Ministers Office, the nowadays Palace of Brigades, mother Theresa square, the maternity hospital as well as many residential blocks and high schools.



Tirana g



Tirana e priti me protesta pushtimin fashist italian më 7 prill 1939. Ushtritë italiane hynë në Tiranë të nesërmen, më 8 prill. Pushtimi fashist italian vazhdoi deri më 8 shtator 1943, kur hynë trupat gjermane. Gjatë viteve të luftës, qëndresa e popullsisë së kryeqytetit kundër pushtimit, për rivendosjen e pavarësisë së vendit ishte gjithnjë në rritje. Brenda në qytet në fillim u zhvillua me veprime politike demonstrata antifashiste, pastaj veprime të armatosura (njësitet guerile) dhe më në fund u ngritën institucionet

e pushtetit të ri antifashist (këshillat nacionalçlirimtarë). Pushtimi ushtarak gjerman, sado që ishte më i egër, nuk e dobësoi në Tiranë hovin e Luftës ANÇ. Me vullnetarët që dolën nga banorët e Tiranës, u formuan në afërsi të saj katër brigada të UNÇSH: Brigada II, III, XXII dhe XXIII S. Tirana u çlirua më 17 nëntor 1944. Më 28.11.1944, ditën e 32-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në Tiranë u vendos Qeveria Demokratike e



gjatë luftës...

formuar në Mbledhjen II të KANÇ në Berat.

Në vitet 1939-1944 në Tiranë u ndërtuan shumë objekte publike dhe të kapitalit privat italian e vendës, që synonin të përmirësonin strukturën ekonomike dhe urbanistike të kryeqytetit, si hotel "Dajti", Kryeministria, Pallati i sotshëm i "Brigadave", kompleksi i sheshit të sotshëm "Nënë Tereza", Materniteti, ndërtesa e re e gjimnazit, pallate banimi për nëpunësit dhe ushtarakët, kazerma.



Tirana 19



In the end of 1944, Tirana counted 59.900 inhabitants, a figure that was doubled in five years time. In the first years after the war efforts were devoted to reconstruction and restoration of the war damages. Deep reforms were undertaken as of 1947 for the establishment of centralized economy. In the following years economy developed according to the socialist principles, the same applied to education, culture and art. Special

attention was devoted to industrialization. Plants and factories were build, some of them employing more than 1000 workers others were even employing over 5000 workers. Amongst such were the wood processing plant, the shoes factory, metal work plant, the glass work factory, porcelain factory, silicate bricks factory, food products factory and the auto-tractor's plant.

The industrial development was followed by population growth i.e. from 108.200



1944-1990

inhabitants in (1955) it went to 152.700 inhabitants in (1969), 189 000 inhabitants in (1979) and 238.100 inhabitants in (1989).

Tirana recognized a great development in education and culture. Higher education institutions were established for the first time in Albania: the (two years cycle) High Pedagogic Institute was established in 1946, during 1951-1953 six university level institutions were established; in 1957 was established



the Tirana's State University followed by the High Institute of Arts in 1966, High Institute of Physical Culture in 1960, the Supreme Military Academy in 1962. The Institute of Sciences was established in 1947 which was later on integrated into Tiranas State University.

In 1991 was established the Agricultural University based on the High Institute of Agriculture that was established in 1951. Later on, different scientific institutes of various profiles, were established, such as

Tirana 19



publications, theatrical shows, song festivals and Radio Tirana increased its capacity. The Albanian Public Television started its operations in 1960. Hospitals increase in number and hospital services improved considerably.

Hotel Tirana is the first multi storey building constructed in 1970. It (hotel) is located on the northern side of the Scanderbeg square flanked by the Palace of Culture and the National Historic Museum. It's location was a result of a

(industry, construction, mining, architecture, urban planning, transport). The Academy of Sciences was established in 1972 including 13 institutes within it's organization structure. The artistic and cultural life grew rapidly; the Albanian National Theatre and League of Writers of Albania was founded in 1947. In 1945, Tirana had a library of 12.000 volumes whereas in 1990 Tirana counted 13 public libraries out of which only the National Library contained over 1 million books. Cultural and artistic life did intensify i.e. number of literary



1944-1990

partial urban planning of the city center. It has 16 stores and a slightly modern architecture composed of geometric shapes and volumes. The facade of the hotel made of travertine matches with the color of the Palace of Culture and the National Historic Museum. This hotel introduced a novelty to the Albanian architecture of the time for it paved the way for the construction of similar buildings in city centers that became the symbolic to the new architecture of Albania.

On the other side, the more the economy strengthened the more the political and



ideological dictatorship of the PLA did grow. The communist power deepened the internal dictatorship and isolation of Albania with the outer world. The politics of the time as well as the economic hardship, especially the food shortage, brought about growing dissatisfaction of the masses and in 1990's people went on the streets protesting against the regime. It all started right the fall of the Berlin Wall.

Tirana në vitet



Kur u çlirua, Tirana kishte 59.900 banorë, shifër që u dyfishua pas pesë vjetësh. Për disa vite vazhdoi periudha e rindërtimit të plagëve të luftës. Duke filluar nga viti 1947 u ndërmorën reforma të thella për vendosjen e ekonomisë së centralizuar. Në vitet në vijim ekonomia u zhvillua sipas parimeve të socializmit dhe po ashtu kultura, arsimi dhe arti. Kujdes i veçantë iu kushtua industrializimit. U ndërtuan uzina e kombinat, disa nga të cilat kishin mbi 1000 punëtorë, madje ndonjë dhe mbi 5000 punëtorë. Midis tyre ishin: Kombinati i drurit

dhe Fabrika e këpucëve, Kombinati i tekstileve në lagjen e sotme Kombinat, në fillim me 5000 punëtorë e më pas me 20.000 punëtorë; Uzina e prodhimeve metalike, Fabrika e qelqit, Fabrika e porcelanit dhe Kombinati i tullave silikate, Kombinati ushqimor, Kombinati i auto-traktorëve etj.

Si pasojë e këtyre zhvillimeve, popullsia u rrit nga 108.200 banorë (1955), në 152.700 mijë banorë (1969), 189 mijë banorë (1979) dhe 238.100 mijë banorë (1989).



et 1944-1990

Tirana njohu zhvillim të madh në fushën e arsimit dhe të kulturës. U ngritën për të parën herë institute të larta arsimore: më 1946 Instituti i Lartë Pedagogjik Dyvjeçar, më 1951-1953 u themeluan gjashtë institute të larta në shkallë universitare, më 1957 u themelua prej tyre Universiteti Shtetëror i Tiranës më vonë u hapën Instituti i Lartë i Arteve (1966), Instituti i Lartë i Fizkulturës (1960), Akademia e Lartë Ushtarake (1962). U krijua dhe Instituti i Shkencave (1947), i cili më 1957 u integrua në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Më 1991 u



themelua Universiteti Bujqësor mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor të Tiranës të themeluar më 1951. Më vonë u organizuan institute shkencore për profile të ndryshme (industri, miniera, ndërtim, arkitekturë e urbanistikë, transport). Më 1972 u themelua Akademia e Shkencave e Shqipërisë me 13 institute shkencore në varësi të saj. Me ritme të shpejta u zhvillua jeta kulturore dhe artistike. U krijua Teatri Kombëtar Shqiptar (1947), dhe Lidhja e Shkrimtarëve

Tirana në vitet



të Shqipërisë. Nga një bibliotekë me 12 mijë vëllime që kishte më 1945, Tirana më 1990 u bë me 13 biblioteka publike, nga të cilat vetëm Biblioteka Kombëtare me mbi një milion libra. U rrit numri i botimeve letrare, i shfaqjeve teatrore, i koncerteve, i festivaleve të këngës shqiptare, u shtua fuqia dhe programet e Radio Tiranës, filloi transmetimet Televizioni Shqiptar (1960). U shtua numri i spitaleve dhe niveli i shërbimit mjekësor u përmirësua.

Hoteli i parë shumëkatësh i ndërtuar në Shqipëri në vitet 1970 është Hotel Tirana. Ai ndodhet në pjesën veriore të sheshit

Skënderbej, në ansambël me Pallatin e Madh të Kulturës dhe Muzeun Historik Kombëtar. Vendosija është bërë në bazë të një studimi pjesor urbanistik të qendrës së Tiranës. Hoteli është me 16 kate. Arkitektura e hotelit është e stilit modern e të thjeshtë, e kompozuar me forma dhe vëllime gjeometrike. Me travertinin si material i jashtëm lidhet në ngjyrë me Pallatin e Madh të Kulturës dhe Muzeun Historik Kombëtar. Ndërtimi i këtij hoteli solli risi për arkitekturën shqiptare, sepse dhe në qytetet e tjera kryesore të vendit filloi ndërtimi i hoteleve të larta në qendër, të cilat u kthyen në simbole të një arkitekture të re shqiptare



et 1944-1990

Nga ana tjetër, sa më tepër zhvillohej baza ekonomike, aq më shumë forcohej diktatura politike dhe ideologjike e udhëheqjes së PPSH. Pushteti komunist e thelloi vazhdimisht diktaturën e brendshme dhe izolimin e Shqipërisë në marrëdhëniet me botën e jashtme. Kjo politikë dhe gjendja e vështirë ekonomike, veçanërisht mungesat ushqimore, sollën pakënaqësinë e masave popullore, të cilat më 1990 shpërthyen në demonstrata kundër regjimit. Rasti erdhi fill pas shembjes së murit të Berlinit.



Tirana after



In July 1990 happened the so called "assault on the Embassies". In December 1990, "the students' movement " supported by the workers' movement, forced the communist government to allow for pluralism which led to the process of the communist state collapse and establishment of market economy. The first opposition parties were born. In June 1991 the Party of Labor of Albania changed its name

into the Socialist Party of Albania. In the general elections of March 31-st, 1992, the Democratic Party of Albania won the majority of seats in Parliament forming the democratic government. Thus, Tirana entered into the transition period i.e. from communism to capitalism. During this period of time, Tirana went through and is still going through radical change. The collapse



r the 1990's

the centralized economy system resulted in the closing of hundreds of state run factories and plants. In the beginning of the 1990's, due to the high rate of unemployment, thousands of youth left the country and thousands of citizens from remote areas and other cities of northeastern Albania settled in Tirana and its suburbs. The number of the newly settled surpassed by many times the number of people that migrated abroad. As a result, Tirana's population grew in unprecedented numbers and this trend



could still be seen today.

The post 1990's brought about great changes in economy, culture, demography, town planning and the socio-political life.

Today, Tirana is still growing and changing, it is the center of the administrative and political life of Albania hosting almost all the state institutions as well as all the Embassies of the countries with which Albania has diplomatic relations. Tirana is the biggest education center of the country.

Tirana after

Tirana is a vibrant city full of hotels, restaurants, pubs, bars youth and artistic centers that enable an active and cultural life both for locals and foreigners visiting Tirana. It also hosts a lot of local and international events such workshops, conferences, festivals and spectacles this, making Tirana a very open and recognized city to the world. Tirana has become the city that never sleeps.



r the 1990's



Tirana pas




Në korrik 1990 ndodhi i ashtuquajti "sulm i ambasadave". Në dhjetor 1990 lëvizja "studentore" e përkrahur nga lëvizja punëtore, e detyroi qeverinë komuniste të lejonte pluralizmin politik, i cili i hapi rrugën procesit të përmbyesjes së shtetit komunist dhe të vendosjes së ekonomisë së tregut. Në Tiranë u themeluan partitë e para opozitare. Në qershor 1991 Partia e Punës, e cila kishte drejtuar diktaturën, u shpërbë. U themelua Partia Socialiste e Shqipërisë. Në zgjedhjet e 31 marsit 1992 Partia Demokratike me aleatët e saj siguruan

shumicën e deputetëve dhe formuan qeverinë demokratike. Kështu Tirana u përfshi në periudhën e tranzicionit, të kalimit nga regjimi komunist në sistemin kapitalist. Gjatë kësaj periudhe Tirana ka pësuar dhe vazhdon të pësojë ndryshime rrënjësore. Fundi i ekonomisë së centralizuar komuniste solli mbylljen e qindra fabrikave dhe punishteve shtetërore. Në fillim të viteve 1990, nën shtytjen e papunësisë dhe të aspiratës për



viteve 1990

lëvizjen e lirë, me dhjetëra mijë të rinj mërguan jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, me qindra mijë banorë të krahinave malore, sidomos nga pjesa verilindore e vendit u dyndën në kryeqytet dhe në rrethinat e tij. Në qytetin e Tiranës numri i të ardhurve e tejkaloi disa herë numrin e të mërguarve. Si rrjedhim i këtij procesi, brenda 10 vjetëve, popullsia e Tiranës u rrit me ritme të papara ndonjëherë, që vazhdojnë edhe sot. Pas vitit 1990, gjatë periudhës së tranzicionit, në Tiranë ndodhën ndryshime të mëdha e të thella në të gjitha fushat, në ekonomi, kulturë, demografi, urbanistikë, në jetën politiko-



shoqërore etj.

Sot, Tirana është një qytet që rritet dhe ndryshon përditë dhe është qendra e jetës politike dhe administrative e Shqipërisë ku janë vendosur pothuajse të gjitha institucionet shtetërore. Në Tiranë janë të vendosura po ashtu të gjitha përfaqësitë diplomatike të shteteve me të cilët Shqipëria ka marrëdhënie diplomatike dhe ajo gjithashtu është qendra më e madhe e edukimit në vend.

Tirana është një qytet i mbushur me hotele,

Tirana pas

restorante, bare, pub-e, qendra rinore dhe artistike, që mundësojnë një jetë aktive dhe kulturore të shumëllojshme për vendasit dhe të huajt që vizitojnë Tiranën. Gjithashtu Tirana është një qendër aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të rëndësishme, si seminare, konferenca, festivale, spektakle etj, që e bëjnë një qytet tashmë të njohur dhe të hapur me botën. Tirana është shndërruar në qytetin që nuk fle kurrë.



viteve 1990



Attractions of Tirana

Tirana is rich of prehistoric dwellings and archeological sites, fortresses, monuments, etc. All this heritage is testimony to Tirana's ancient history and its continuation to date which is a precious tourist potential.

THE CASTLE OF TIRANA

The castle is a field fortification with a rectangular plan of 160 x 125 meters, the longest side being the east-west wall. The preserved constructions of some of the towers and segments of the surrounding walls indicate that the castle is likely to have been built for the first time in antiquity, perhaps in the early Byzantine period (IV - VI century A.D). It is believed to belong to one of the fortifications built or reconstructed by the Emperor Justinian in the New Epirus (province of Durrës).

A part of the city walls that are seen today on land belong to the constructions of the last centuries, which were built by Ahmet Pasha Bargjini (1788 - 1809) in the last decade of the XVIII century on the ruins of the old castle.



In 1798 the castle fell into the hands of the Toptani family of Kruja. During this period it was placed in the center and became a subject of war between the Toptani family and the Bushatllinj rulers of Shkodra. In 1817 it underwent a siege of 5 (five) months, which had serious consequences not only for the fortress but also for a big part of the city. After the bombing, the castle was rebuilt in part by the Toptani family, until 1832 when it fell due to the incursions of the Ottoman army led by Mehmet Resit Pasha, who ordered the destruction of all forts.

Today a part of the north wall and the leaflets on the southern side of it are still conserved, which is combined with the enchanting surrounding infrastructure



Atraksione të Tiranës



Tirana ka një truall të lashtë dhe shumë të pasur me site të lashta arkeologjike, vendbanime prehistorike, qytete, fortifikime, monumente, objekte kulti dhe gjetje arkeologjike. Kjo pasuri dëshmon për lashtësinë dhe vazhdimësinë e jetës historike dhe është njëkohësisht një potencial i çmuar turistik.

KALAJA E TIRANËS

Kjo kala ndodhet në qendrën historike të qytetit të Tiranës. Ajo është një fortifikim fushor me planimetri drejtkëndore 160 x 120 m, me pjesën më të gjatë lindje - perëndim. Themelet e mureve rrethuese i takojnë ndërtimeve të kryera në kohën e Ahmet Pashë Bargjinit në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Në vitin 1798 kalaja ra në duart e familjes Toptani nga Kruja. Ndërsa vitin 1817 ajo përjetoi një rrethim pesë mujor nga feudalet bushatllij të Shkodrës,

nga i cili pati pasoja të rënda jo vetëm për kalanë por edhe për një pjesë të madhe të qytetit. Pas bombardimit u rindërtua pjesërisht nga Toptanasit, por nuk pati jetë të gjatë sepse në vitin 1832 ajo u shemb me urdhër të Vezirit të Madh, Mehmet Reshit Pasha. Nga kalaja e vjetër, sot ruhet një pjesë e murit verior dhe trakte në anën jugore të saj. Gjatë gërmimeve të kryera në vitet 2001 dhe 2008, autorët menduan në mënyrë entusiastike se kalaja i përket njërit prej fortifikimeve të ndërtuara ose të rindërtuara nga Perandori Justinian në shekullin e VI., por nuk kanë mundur të sjellin argumente bindëse as arkeologjike as historike në mbështetje të këtij mendimi.




Attractions of Tirana

MOSAIC OF TIRANA

Discovered in 1972, during the building of a residential block, remains one of the earliest testimonies on Tirana's soil. During the first phase of discovery appeared the ruins of an ancient building, part of which was paved with a mosaic of geometric and floral patterns. Immediately, the surface area was taken over by Institute for Monuments of Culture because it was deemed that it was a Villa Rustica dating back to 2-nd and 3-rd centuries A.D. that was converted to a paleo Christian building during the 4-th and 7-th centuries. Nevertheless, it is worth mentioning that herein there were never conducted systematic archeological excavations spare for some minor surveys for preservation purposes during 2003-2004. Despite the limited volume of

excavations, it is deemed that this a Villa Rustica that extends well beyond the already discovered mosaic. To date, there hasn't been found any data in support of its conversion into a paleo Christian building. Even though there are some efforts made in interpreting some signs contained on some of the bricks or the motifs of the mosaic, still it is not enough to corroborate such a transformation. Notwithstanding the above, this archeological object of middle to late Roman Empire era is a worthy tourist attraction



Atraksione të Tiranës

MOZAIKU I TIRANËS



I zbuluar qysh në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve të bllokut “Partizani”, objekti i njohur si Mozaiku i Tiranës, mbetet si një nga dëshmitë më të hereshme në truallin e qytetit. Në fazën e parë të zbulimit dolën në dritë rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga ambientet e të cilës ishte i shtruar me mozaik me motive të pasura gjeometrike dhe floreale. Menjëherë sipërfaqja e monumentit u rrethua dhe u vu në mbrojtje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Në këtë fazë, u mendua se kemi të bëjmë me një vila rustica të shekujve II-III pas Kr. e cila transformohet në shekujt IV -VI në një ndërtim paleokristian. Duhet të pohojmë se në këtë vend nuk janë kryer asnjëherë gërmime sistematike arkeologjike, por vetëm disa sondazhe të vogla me karakter shpëtimi në vitet 2003-2004. Megjithatë të pakta, këta gërmime e përforcuan mendimin se kemi të bëjmë vetëm me një vila rustica, e cila shtrihet në një sipërfaqe shumë më të madhe se ajo që është zbuluar. Ndërkohë nuk është gjetur asnjë e dhënë për transformimin në një ndërtim paleokristian. Disa përpjekje interpretuese mbi disa shenja në tulla apo motivet e mozaikëve mbeten ende të pamjaftueshme për të vërtetuar një transformim të tillë. Kjo situatë nuk ja ul aspak vlerat këtij objekti arkeologjik të kohës së mesme dhe të vonë perandorake romake, të pagëzuar simbolikisht me emrin “Mozaiku i Tiranës”. Ai funksionon sot më së miri, si një nga objektet atraktive të qytetit.



Attractions of Tirana

THE TANNER'S BRIDGE

is an 18th century Ottoman period stone footbridge built by the tanner's craft which had a special position in social and economic life of Tirana in this period of time.

The bridge was once part of the Shëngjergj Road that linked Tirana with the eastern highlands.

